



Në kuadër të zhvillimit të bujqësisë në Komunën e Drenasit - Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural duke u bazuar në Nenin 16,17,18 të rregullores Nr.02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjës së Subvencioneve, njofton të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojnë për Projektin e poshtëshënuarë :

THIRRJE PËR APLIKIM

- Furnizimi i fermerëve me Serra 50m² - Perimtari

| | | | |
|---|--------|------------|-------|
| REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY | | | |
| Pranuar | | 20/06/2022 | |
| Nj. Org | Numër | Shifra | Vlera |
| 21 | 400/03 | 28716 | |

Kriteret që duhet plotësuar për aplikim :

1. Fermeri duhet të jetë banor i Komunës së Drenasit;
2. Të posedoj sipërfaqe punuese të tokës e mjaftushme për serren, të këtë vend të përshtatshëm për kultivim;
3. Të jetë i gatshëm për participim;
4. Në bazë të rregullores Nr.02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 - Përparësi në kushte të barabarta kanë:
 - a) Fermerët që nuk janë përfytyes më parë nga DBPZHR në tri vitet e fundit;
 - b) Fermerët që nuk janë përfytyes nga MBPZHR-ja dhe Donatorë të tjerë brenda vitite fiskal;
 - c) Fermerët të cilët jetojnë në zona malore;
 - d) Të rinjtë;
 - e) Gjinia Femrore;
 - f) Familjet që kanë përsone me nevoja të veqanta;
 - g) Familjet me asistencë sociale, nënat vetushqyese;
 - h) Fermerët që janë të regjistruar para thirrjes publike.

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

1. Plotësimi i aplikacionit,
2. Kopja e leternjoftimit të Republikës së Kosovës,
3. Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë,
4. Numrin identifikues të fermerit (NIF)
5. Deklaratë për participim nga fermeri
6. Fletën Poseduese të tokës në emer të aplikuesit ose familjarit të aplikuesit;
7. Dëshmi për Gjendjen Ekonimike(familjet me asistencë sociale).
8. Dëshmi nese kanë përsone me nevoja të veqanta.

Afati për aplikimit nga data 20.06.2022 deri me 04.07.2022

Drenas 2022

